Situatat sinoptike të tetorit 2021 shpesh ishin rezultat dhe i pranishëm në vend ndodhjes së vijave frontale mbi hapësirat detare të Adriatikut dhe Jonit. Diferencat e theksuara barike midis masave ajrore me origjinë dhe karakteristika të ndryshme, përcollën mbi vendin tonë reshje, të cilat shënuan intensitetet më të larta në detet në fjalë shoqëruar me një ulje graduale në drejtim të brendshëm të vendit.

The synoptic situations of October 2021 were often the result of the presence of the location of the front lines over the Adriatic and Ionian Sea areas. Significant baric differences between air masses of different origins and characteristics, conveyed rainfall over our country, which marked the highest intensities in the seas area accompanied by a gradual decrease towards the interior of the country.

Reshjet e dëborës së muajit tetor 2021 ishin të pranishme disa herë kryesisht në zonat e larta të vendit duke u karakterizuar me një shtresë të vogël dhe në zona të kufizuara, të cilat nuk patën një qëndrueshmëri të gjatë në kohë. Ato me lartësinë e tyre të ulët nuk u bënë problematike për transportin. Për ilustrim një pamje e dhënë në figurën Nr.34 nga media për datën 14 tetor në zonën e Korçës.

Figura Nr. 34. - Reshje të pakta dëbore më datë 14 tetor 2021 në zonën e Korçës. / Low snow precipitation on date October 14, 2021 on the Korça district.

Një pamje satelitore (MODIS) mbi situatën e reshjeve të dëborës në territorin e Shqipërisë për datën 27 tetor 2021 jepet në figurën Nr.35.



Shtresa e Mbulesës së dëborës (MODIS) (Normalized Difference Snow Index (NDSI)) tregon praninë e mbulesës së borës mbi tokë dhe trupat ujorë si një indeks që lidhet me praninë e dëborës. Mbulesa e dëborës NDSI rrjedh nga reflektimi i borës pa re të kapur nga instrumentet e MODIS, dhe për këtë arsye kjo pamje tregon praninë e borës gjatë ditës dhe vetëm në kushte të pastra të qiellit pa re.

The snowfall of October 2021 was present several times mainly in the high areas of the country being characterized by a small layer and in limited areas, which did not have a long stability over time. Those with their low height did not become problematic for transportation. For illustration, a picture given in figure No.34 by the media on October 14 in the Korça area.



A satellite image (MODIS) on the situation of snowfall in the territory of Albania for October 27, 2021 is given in figure No.35. The MODIS Snow Cover (Normalized Difference Snow Index (NDSI)) layer shows the presence of snow cover over land and water bodies as an index related to the presence of snow. NDSI snow cover is derived from the cloud free snow reflectance sensed by the MODIS instrument, and hence this layer shows presence of snow during day time and under cloud clear condition only.

Figura Nr. 35. – Pamje satelitore nga MODIS për datën 27 tetor 2021 në lidhje me dëborën e pranishme. / Satellite view of MODIS on date October 27, 2021 related to snow presence.

Shtresa e mbulesës së dëborës (MODIS) (Normalized Difference Snow Index) mundësohet nga të dy satelitët Terra (MOD10) dhe Aqua (MYD10). Rezolucioni i sensorit dhe imazhit është 500 m dhe rezolucioni i kohor është i përditshëm.

The MODIS Snow Cover (Normalized Difference Snow Index) layer is available from both the Terra (MOD10) and Aqua (MYD10) satellites. The sensor and imagery resolution is 500 m and the temporal resolution is daily.

Agrometeorologji.

Muaji tetor 2021 në fakt shënoi "fillimin" e stinës së vjeshtës, pasi siç u analizua dhe prezantua dhe në buletin e mëparshëm Nr.57, shtatori ishte më shumë një tejzgjatje e stinës së verës se sa një muaj vjeshte, që pasoi muajin më të ngrohtë të vitit gushtin.

Kësisoj krahasuar me shumë vite më parë ku në tetor shënohej fundi i periudhës së vegjetacionit në një pjesë të territorit të Shqipërisë; në vitet e fundit siç dhe është evidentuar ky mbarim është zhvendosur në kohe me një vonesë prej rreth 2 javësh, natyrisht duke variuar sipas viteve, por duke ngelur konstant fakti që kjo periudhë ka shënuar një zgjatje. Një zgjatje e periudhës së vegjetacionit do të thotë më shumë mundësi për kultivimin e vaseteve me cikël më të gjatë vegjetativ e po ashtu dhe mundësi për rendimente më të larta, apo krijimin e mundësive për rritje e zhvillim edhe të kultivarëve të pa mundur më parë. Gjithashtu duhet thënë se pikërisht një nga treguesit më të rëndësishëm siç është ai i burimeve agroklimatike të ngrohtësisë ka shënuar një rritje të ndjeshme. Ndaj në këtë kontekst është mirë të njihet se si ka evoluar ky tregues ndër vite dhe duke krahasuar të dhënat e vitit 2021 me ato të periudhave mesatare shumëvjeçare të mëparshme të kemi një gjykim më të saktë dhe për ndryshimet që po përcjell klima në vitet e fundit në hapësirën e Shqipërisë në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë.



Agrometeorology.

October 2021 actually marked the "beginning" of the autumn season, analyzed and presented in the previous bulletin No.57,

September was more an extension of the summer season than an autumn month, which followed August, the warmest month of the year. Thus, compared to many years ago, when October marked the end of the vegetation period in a part of the territory of Albania; in recent years as evidenced this termination has shifted in time with a delay of about 2 weeks, of course varying by years, but remaining constant the fact that this period has marked an extension.

An extension of the vegetation period means more opportunities for the cultivation of varieties with longer vegetative cycle as well as opportunities for higher yields, or the creation of opportunities for growth and development of previously impossible cultivars. It should also be noted that exactly one of the most important indicators such as that of agro-climatic heat sources has marked a significant increase.

Therefore, in this context, it is good to know how this indicator has evolved over the years and comparing the data of 2021 with those of previous multi-year average periods to have a more accurate judgment of the changes that the climate is following in recent years in Albania region in the sector of agriculture and livestock.





Figure Nr.36. – Treguesi i shumës së temperaturave aktive të ajrit mbi pragun 10°C për muajin tetor 2021 në disa vendmatje meteorologjike të Shqipërisë. / The index of the sum of active air temperatures above the threshold 10°C for October month 2021 at some meteorological stations of Albania.

Treguesi i shumës së temperaturave aktive të ajrit mbi pragu 10°C është përlogaritur në bazë të metodikave të caktuara dhe të dhënat për disa vendmatje meteorologjike të përzgjedhura për zona e nën-zona të ndryshme klimatike janë dhënë në figurën Nr.36.

Situatën favorizuese për një vegjetacion aktiv ndonëse pranë fundit të periudhës së vegjetacionit, por gjithsesi në nivele të mira e paraqesin dhe pamjet satelitore të treguesit NDVI për hapësirën e Shqipërisë gjatë datave 6, 13, 20 dhe 27 tetor 2021 ku treguesi në fjalë ngelet në vlera të larta dhe një degradim apo ulje e vlerave të tij lehtësisht fillon të duket vetëm në zonat e larta të vendit, siç tregohet dhe në figurën në vijim Nr.37

The indicator of the sum of active air temperatures above the threshold of 10°C is calculated based on certain methodologies and data for several meteorological stations selected for different climatic zones and sub-zones are given in Figure No.36.

The favorable situation for an active vegetation, although near the end of the vegetation period, but still in good levels are illustrated by satellite images of the NDVI indicator for the space of Albania during the dates 6, 13, 20 and 27 October 2021 where the indicator remains at high values and a degradation or reduction of its values are present only in mountain areas, as can be showed in the following figure nr. 37.



Treguesi i thatësirës për muajin tetor nuk shënoi vlera të larta apo problematike në territorin e Shqipërisë. Për ilustrim në figurën Nr.38 paraqitet situata e treguesit të reshjeve standart (TRS) për muajin tetor 2021 për zonën e gadishullit Ballkanik.

The drought indicator for October did not show high or problematic values in the territory of Albania. For illustration in figure No.38 is presented the situation of the standard precipitation indicator (SPI) for October 2021 for the area of the Balkan Peninsula.




Figure Nr.38. – Bilanci i ujit sipërfaqësor i vlerësuar me simulime duke përdorur modelet e parashikimeve numerike të motit (PNM). / Surface water balance assessed with simulation using numerical weather prediction (NWP) model.

Bilanci i ujit sipërfaqësor

Bilanci i ujit sipërfaqësor vlerësohet me simulim duke përdorur modelin e parashikimit numerik të motit (NWP). Simulimet kryhen me Model Johidrostatik Meso-sale (NMM) me rezolucioni hapësinor prej 7 km, që përfshihet në analizat operationale të Qendrës Evropiane për Parashikimin e Motit Afat Mesëm (ECMWF). Modelet klimatologjike afatgjata janë llogaritur me simulimet e modelit NMM për periudha kohore të plota të 30 viteve të fundit (aktualisht e përdorur 01.01.1990 – 31.12.2019).

Bilanci i ujit sipërfaqësor është përlllogaritur për 60 ditët e fundit. Bilanci i akumuluar i ujit sipërfaqësor paraqitet në klasa përqindjeje sipas modelit klimatologjik. Në figurën Nr. 38 paraqiten vlerësimet për datat 7, 17 dhe 27 janar 2021.

Information about SWB

Surface water balance is assessed with simulation using numerical weather prediction (NWP) model. Simulations are performed with Non-hydrostatic Meso-scale Model (NMM) with 7 km spatial resolution, nested into operational analyses of European Centre for Medium Range Weather Forecast (ECMWF). Long-term model climatology was computed with NMM model simulations for time period of the last full 30 years (currently used 01.01.1990 – 31.12.2019).

Surface water balance is accumulated for the past 60 days. Accumulated surface water balance is presented in percentile classes according to model climatology. In figure No.38 estimates are presented for the dates 7, 17 and 27 January 2021.

Energjitë e rinovueshme.

Era është një burim i rëndësishëm i energjiave alternative. Duke qenë se herë pas here mungesat e energjisë po bëhen problematike është e nevojshme të shihen dhe mundësitë që natyra në vende të ndryshme ofron për energji të rinovueshme.


Në vijim për muajin tetor paraqitet një vlerësim për erën në hapsirën e Republikës së Kosovës për lartësinë 120 metra nga sipërfaqja e tokës dhe fuqinë e saj të mundshme të konvertuar në energji elektrike, si një potencial i rëndësishëm që mund të shfrytëzohet me sukses duke implementuar teknologjitë më të fundit, që njihen në këtë fushë në ditët e sotme.



Renewable energies.

Wind is an important source of alternative energies. Given that from time to time energy shortages are becoming problematic it is necessary to look at the opportunities that nature in different countries offers for renewable energy.

The following for October presents a wind assessment in the space of the Republic of Kosovo for the height of 120 meters from the ground surface and its potential power converted into electricity, as an important potential that can be successfully exploited by implementing technologies the latest, known in this field nowadays.



Përgjithësisht zonat me shpejtësi ere mbi 5m/sec konsiderohen efektive në lidhje me shfrytëzimin e energjisë së erës.


Paraqitjet e të dhënave në hartat e figurave Nr.39 dhe Nr.40 evidentojnë si zona që duhen parë me prioritet sa i takon mundësisë për shfrytëzimin e këtij potenciali ende të pa përdorur hapësirën në perëndim të Deçanit, në perëndim dhe jug të Gjakovës, si dhe ato në VP të Podujevës e në lindje të Prishtinës.

Natyrisht një analizë më e detajuar për çdo muaj do të mundësonte një vlerësim më të plotë të zonave më të përshtatshme në lidhje me potencialin që ofron klima e Kosovës sa i takon këtij burimi energjie që ofron era në këtë hapësirë.

Areas with wind speeds above 5m/sec are generally considered effective in relation to the use of wind energy.

The representations of the data in the maps of figures Nr.39 and Nr.40 highlight as areas that should be seen with priority in terms of the possibility to use this potential still unused space in the west of Deçan, in the west and south of Gjakova, as and those in the NW of Podujeva and east of Prishtina.

Of course, a more detailed analysis for each month would enable a more complete assessment of the most suitable areas in terms of the potential offered by the climate of Kosovo related to this energy which offered by the wind in this area.





Temperaturat mesatare gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit deri në Tetor 2021 u karakterizuan me vlera mbi mesataren në shumicën e zonave tokësore si dhe për pjesën më të madhe të sipërfaqes së oqeanëve. Vlerat më të larta mbi mesataren shumëvjeçare u regjistruan kryesisht në veriun e largët të Siberisë dhe detet ngjitur me Arktikun, Kanadanë verilindore dhe Grenlanda, Afrikën veriperëndimore, Lindjen e Mesme dhe Rrafshnaltën Tibetane, dhe jugu i skajshëm i Amerikës së Jugut dhe Gadishulli Antarktik. Pjesa më e madhe e kontinentit Europian rezulton të ketë vlera mbi mesataren, duke përfshirë Gjermaninë, Spanjën veriore dhe zonën veriore të Detit të Zi, me vlera pak nën mesataren.

Mesatarja e një periudhe dymbëdhjetë mujorë zbut ndryshimet afatshkurtra (siç mund të jenë ato mujore) të temperaturave mesatare rajonale dhe globale (shiko Fig. 41). Në nivel global periudha dymbëdhjetë mujorë deri në tetor 2021 ishte 0.28°C më e lartë se mesatarja $1991\div 2020$. Kjo anomali dymbëdhjetë mujorë është shumë nën mesatare krahasuar dhe me periudhat e tjera dymbëdhjetë mujorë si ato që përfundojnë në shtator 2016 si edhe maj dhe qershor 2020, tre periudhat më të ngrohta në këtë rekord të dhënash. Viti kalendarik më i ngrohtë rezulton vitit 2016, me një vlerë të temperaturës 0.44°C mbi mesataren $1991\div 2020$.

Average temperatures during the last twelve months until October 2021 were characterized by above average values over most land areas as well as for the majority of the ocean surface. Higher values above the average were recorded mainly in the far north of Siberia and the adjacent Arctic seas, northeastern Canada and Greenland, northwestern Africa, the Middle East and the Tibetan Plateau, and over the far south of South America and the Antarctic Peninsula. Most of the European continent turns out to have values above average, excluding Germany, northern Spain and the northern Black Sea area with values slightly below average.

Averaging over twelve-month periods smooths out shorter-term variations in regional- and global-average temperatures (Fig. 41). Globally, the twelve-month period to October 2021 was 0.28°C warmer than the $1991\div 2020$ average. This twelve-month average anomaly is well below the 0.46°C average for the twelve-month periods ending in September 2016 and May and June 2020, the three warmest periods in this data record. The warmest calendar year is 2016, with a temperature 0.44°C above the $1991\div 2020$ average.




Figure Nr.41 - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për periudhën nëntor 2020 deri tetor 2021 kundrejt periudhës $1991\div 2020$. / Surface air temperature anomaly for the period November 2020 until October 2021 compare to the period $1991\div 2010$ (Copernicus, ECMWF, etc.).




Figura Nr.42. – Vlerat mesatare të anomalive të temperaturave të ajrit për periudhën 12 mujore në shkallë globale dhe Europiane nga janari 1979 deri në tetor 2021, krahasuar me periudhën 1991÷2020. / The averages values of global and European-mean surface air temperature anomalies for 12-month period from January 1979 to October 2021, relative to 1991÷2020. Data source: ERA5. Credit: Copernicus Climate Change Service/ECMWF.

Në grafikun e paraqitur në figurën Nr.42 janë llogaritur mesataret dymbëdhjetë mujorë të anomalive të temperaturës mesatare globale të ajrit dhe mesatare evropiane krahasuar me 1991÷2020, bazuar në vlerat mujore nga janari 1979 deri në tetor 2021. Shiritat me ngjyra më të errëta janë mesataret për secilin prej viteve kalendarike nga 1979 deri në 2020. Burimi i të dhënave: ERA5. Kreditet: Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike Copernicus / ECMWF.

Pse NASA vlerëson ndryshimin e temperaturës së sipërfaqes globale?

Në fillim të viteve 1970, hulumtimi në atmosferën e Venusit dha një shembull të qartë se si sasi të jashtëzakonisht të larta të gazeve me efekt serrë, të cilat bllokojnë nxehtësinë

In graph showed in figure No.42 are running twelve-month averages of global-mean and European-mean surface air temperature anomalies relative to 1991-2020, based on monthly values from January 1979 to October 2021. The darker colored bars are the averages for each of the calendar years from 1979 to 2020. Data source: ERA5.

Credit: Copernicus Climate Change Service / ECMWF.

Why does NASA estimate global surface temperature change?

In the early 1970s, research into Venus' atmosphere provided a stark example of how extremely high amounts of greenhouse gasses, which trap heat in the atmosphere turned Earth's so-called twin into




Figura Nr.43. – Disa të dhëna se kur vitet me temperatura më të larta ose më të ulta janë vrojtur në kohë (ndër vite) kundrejt ditëve të sotme. / Some data on when the years with the highest or lowest temperatures were observed in time (over the years) versus the present day.

në atmosferë, duke e ashtuquajtur si binjak të Tokës, një planet të pabanueshëm me temperatura të larta sipërfaqësore që do të shkrinin dhe plumbin. Më pas, shkencëtarët u bënë gjithnjë e më të shqetësuar për ndikimin e dioksidit të karbonit dhe gazeve të tjera serrë në Tokë. Në vitin 1981, shkencëtarët e NASA-s ishin të parët që vlerësuan mesataret e temperaturës globale duke përdorur teknikat që evoluon deri në analizën aktuale. Ideja ishte të sigurohej një model për parashikimet e ndryshimeve klimatike në të ardhmen.

an uninhabitable world with blistering surface temperatures that would melt lead. Scientists then became increasingly concerned about the influence of carbon dioxide and other greenhouse gasses on Earth. In 1981, NASA scientists were the first to estimate global temperature averages using the techniques that eventually evolved into the current analysis. The idea was to provide context for predictions of future climate change.

Vlerësimet për Shqipërinë tregojnë se temperaturat mesatare të ajrit për muajin tetor për pesë vitet e fundit 2017÷2021 karakterizohen me vlera mbi mesataren shumëvjeçare.

Përjashtim bën muaji tetor i vitit 2021 me një shmangie të lehtë nën mesataren me -0.6°C. Shmangiet mesatare mujore të pesë vjeçarit të fundit karakterizohen nga vlera mesatare mbi normë me vlerë +1.5°C.

Ecuria mujore sipas viteve paraqitet grafikisht me vlerat përkatëse në grafikun e paraqitur në figurën Nr.44. Reshjet totale për muajin tetor të gjysmë dekadës së fundit kanë pësuar një rënie me afërsisht 32%. Reshjet mbi normë prezente në dy vitet e fundit në muajin tetor kanë zbutur ndryshimet afatshkurtra. Sa i takon numrit të ditëve me reshje në përgjithësi rezultojnë të jenë nën mesataren shumëvjeçare

përkatëse. Me një shmangie të lehtë mbi mesataren karakterizohen dy muaj tetor të viteve 2020 dhe 2021, duke zbutur paksa këtë shmangie, e cila për ditët me reshje mbi pragu 0.1 mm rezultojnë -24.2% krahasuar me vlerat e normës. Për një evidentim të këtyre treguesve në figurën Nr.44 janë paraqitur grafikisht vlerat e muajit tetor sipas viteve përkatëse për periudhën 2017÷2021.






Figure Nr.44. – Vlerat e anormale të temperaturave mesatare të ajrit, lartësisë së reshjeve dhe numrit të ditëve me reshje mbi pragu 0.1 mm gjatë 5 viteve të fundit për muajin tetor për Shqipërinë kundrejt normës.

Values of mean air temperatures anomalies, precipitation sum and number of days with precipitation above the threshold 0.1 mm for October in the last 5 years for Albania, versus norm values.

Estimates for Albania shows that the average air temperatures for October for the last five years 2017 ÷ 2021 are characterized by values above the multi-year average. The exception is October 2021 with a slight drop below the average of -0.6°C. The average monthly deviations of the last five years are characterized by the average value above the norm with a value of +1.5°C. Monthly ongoing by years is presented graphically with the corresponding values in the graph presented in figure No.44. Total rainfall for October of the last half decade has decreased by approximately 32%. Precipitation in the last two years in October has mitigated short-term changes. In terms of the number of rainy days in general it turns out to be below the respective multi-year average. A slight deviation above the average is characterized by the

two months of October 2020 and 2021, slightly mitigating this deviation, which for days with precipitation above the threshold of 0.1 mm results in -24.2% compared to the norm values. For evidence of these indicators in figure No.44 are presented graphically the values of October according to the respective years for the period 2017÷2021.




Informacione shkencore

Klima është konsideruar dhe vlerësohet vazhdimisht si pasuri kombëtare e çdo vendi. Në këtë kontekst metodologji të ndryshme përdoren për vlerësimin dhe klasifikimin e saj. Në vijim paraqitet një vlerësim mbi klimën dhe nëndarjet e saj në shkallë Europiane referuar periudhës 1980÷2016 sipas metodologjisë Köppen – Geiger.

Scientific information

Climate is constantly considered and valued as the national wealth of every country. In this context different methodologies are used for its evaluation and classification. The following is an assessment of the climate and its subdivisions at European level referring to the period 1980÷2016 according to the Köppen - Geiger methodology.



Siç shihet në figurën e dhënë më lart Nr.45. Shqipëria, ndonëse një vend i vogël sa i takon sipërfaqes, përfshihet në disa tipe klimatike. Një gjë e tillë ndodh për shkak se kushtet fiziko gjeografike, lartësia mbi nivelin e detit, kundër drejtimi dhe orientimi i shpateve malore si dhe orientimi VL - JL i zinxhirëve malore, pa lënë mënjanë afërsinë me detet Adriatik dhe Jon, etj., krijojnë një tërësi faktorësh duke mundësuar dhe kushtëzuar një sërë mikroklimash me larshmëri të madhe dhe në distanca jo shumë të largëta nga njëra tjetra. Kjo nxjerr në pah dhe një herë rëndësinë që ka monitorimi meteorologjik dhe fuqizimi i tij si dhe vlerësimi i klimës dhe karakteristikave të saj për Shqipërinë, si një pjesë e rëndësishme e mjedisit, dhe një potencial i madh për degë të caktuara të ekonomisë së vendit siç janë bujqësia, energjia, etj., pa lënë mënjanë dhe dukuritë ekstreme të motit dhe impaktet e tyre të herë pas herëshme.

As seen in the figure given above No.45. Albania, although a small country in terms of area, is included in some climatic types. This is because the physical-geographical conditions, the altitude above sea level, against the direction and orientation of the mountain slopes as well as the VL - SE orientation of the mountain ranges, without leaving aside the proximity to the Adriatic and Ionian seas, etc., create a set of factors enabling and conditioning a series of microclimates with great diversity and at distances not too far from each other. This highlights once again the importance of meteorological monitoring and its empowerment as well as the assessment of the climate and its characteristics for Albania, as an important part of the environment, and a great potential for certain branches of the country's economy such as are agriculture, energy, etc., not to mention the extreme weather phenomena and their occasional impacts.

Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.

To read the other bulletins you are welcome to visit the respective web site, by clicking on the link of IGJEUM.



<http://www.geo.al>



Scientific & Editorial Board:

Prof.Dr. Petrit ZORBA – Chief Editor & Member of the Department of Meteorology PUT – IGEO.

Prof.assoc.Dr. Ilir KAPAJ - Deputy Rector of Agricultural University of Tirana, Albania.

Ph.D. Çezar KONGOLI - Earth System Science Interdisciplinary Center (ESSIC), University of Maryland College Park & Visiting Scientist, National Oceanic and Atmospheric Administration (NOAA), Maryland, USA.

Dr. Azem BARDHI – Head of the Department of Meteorology PUT – IGEO, Albania.

Dr. Parid ALIMHILLAJ – Air traffic management agency of Albania & associated lecture at Polytechnic University of Tirana (PUT), Albania.

External Reviewers:

Dr. Peter Romanov - Research Scientist, NOAA-CREST City University of New York at NOAA/NESDIS Office of Satellite Applications and Research (STAR), USA.

Ph.D. Sante Laviola - National Research Council of Italy (CNR), Institute of Atmospheric Sciences and Climate (ISAC), Bologna, Italy.

English Supervisor: Miss Hillary Hoxha – Queen Mary University of London, UK

Editorial Board approved by the Director of IGEO – Prof.Dr. Ylber MUCEKU

Ky buletini u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë së IGJEO sipas rubrikave si vijon:

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology of IGEO by rubrics as follow:

Data digitalization: Dr. A. Bardhi, Dr. A. Hasimi, Dr. E. Çomo, M.Sc. G. Çela, M.Sc. Ing. A. Gjoni & M.Sc. Ing. E. Hoxha.

Data control, verification & elaboration: Prof. P. Zorba, M.Sc. G. Çela, M.Sc. Ing. A. Gjoni & M.Sc. Ing. E. Hoxha.

Evaluation of monthly meteorological characteristics: Prof.Dr. P. Zorba

Precipitation maps of Albania, composed by applying GIS models: M.Sc. G. Çela.

Agrometeorology: Prof. P. Zorba, Dr. C. Kongoli (NOAA).

Climate change: Prof. P. Zorba, M.Sc. Ing. E. Hoxha.

Renewable Energy: Prof. P. Zorba, M.Sc. Ing. E. Hoxha.

Scientific information: "About Köppen – Geiger climate classification"; Prof. P. Zorba.



“BULETINI MUJOR KLIMATIK” “CLIMATE MONTHLY BULLETIN”

Departamenti i Meteorologjisë

Department of Meteorology

UPT-IGJEUM / PUT-IGWE

E-mail: Klima.Shqiperia@gmail.com

TIRANA, ALBANIA © 2021



Please consider the environment before printing this bulletin.